



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr. 60/01-895/22
Kaçanik, 14.01.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **I (Parë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 14 Janar 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Betim Shala-LDK, Ekrem Livoreka-AAK dhe Arben Thaqi-OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës, në takim mori pjesë Nënkrjetar i komunës, Sabedin Vishi.

Mbledhjen e udhëhoqi, anëtari më i vjetër i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse, Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Nënkrjetari i komunës, Sabedin Vishi, Ju përshëndes të gjithëve dhe ju uroj punë të mbarë anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

z.Ekrem Livoreka, Ju përshëndes të gjithëve, Unë si anëtari më i vjetër i Komitetit për Komunitete do të udhëheq mbledhjen deri në zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për Komunitete. Për mbledhjen e parë të Komitetit për Komunitete, të datës 14.01.2022, është paraparë ky :

REND PUNE

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete,
2. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete,
3. Diskutim rreth planit të punës së Komitetit për Komunitete.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete

z.Ekrem Livoreka, Nëse keni propozime për kryesues të Komiteti për Komunitetit, urdhëroni.

Znj.Lejla Muhaxheri –Çaka, Unë propozoj Ekrem Livorekën për kryesues të Komitetit për Komunitete.

Znj.Arta Avdiu, Unë propozoj Arben Thaqi, për kryesues të Komitetit për Komunitete, pasi që edhe ka përvojë me OJQ.

Z.Betim Shala, Edhe unë propozoj Arben Thaqin , për kryesues të Komitetit për Komunitete, për arsye që ka përvojë me OJQ.

z.Arben Thaqi, Unë mendoj që më mirë do të ishte që kryesuesi i këtij komiteti të jetë nga Kuvendi.

z.Ekrem Livoreka, Propozimet i shtrojmë në votim.Propozimi për Ekrem Livorekën merr 3 vota(Lejla Muhaxheri –Çaka, Arben Thaqi dhe Ekrem Livoreka) ndërsa propozimi për Arben Thaqin i merr 2 votë(Arta Avdiu dhe Betim Shala)

Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete, mori këtë:

VENDIM

Për zgjedhjen e z. Ekrem Livoreka, për Kryesues të Komitetit për Komunitete.

2. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete

z.Ekrem Livoreka, Faleminderit për besimin që ma keni dhënë, dëshiroj të kalojmë sa më mirë në aktivitetet e këtij komiteti.Në këtë komitet do të punojmë së bashku, mirëpres bashkëpunim nga të gjithë.

z.Arben Thaqi, Kjo është një mundësi për ne, për të zgjidhur problemet e komunitetit. Do të mundohem të ndihmojë dhe të jem sa më objektiv në shfaqjen e problemeve të komunitetit, sidomos në aspektin sportiv dhe kulturor, por edhe në aspekte tjera.

z.Ekrem Livoreka, Faleminderit ! Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim lidhur me këtë pikë, atëherë kalojm në pikën tjetër të rendit të punës.

3. Diskutim rreth planit të punës së Komitetit për Komunitete.

Znj.Arta Avdiu, Nëse ka mundësi ndonjë sqarim sepse jemi fillestar në këtë komitet.

z.Arben Thaqi, Nëse ka mundësi të kemi planin e punës së komitetit që ka qenë më herët, si plan orientues.Pastaj ne do të analizojmë dhe të shohim nëse mund të shtojmë apo të heqim diçka në atë plan.

z.Ekrem Livoreka, Po në atë plan ne mund të orientohemi, për planin e punës së komitetit. Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim e mbylli mbledhjen e parë të Komitetit për Komunitete, në ora 11:30.

Procesmbajtës;
Arbnora Kuka



Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka

